



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Të hënë, më 14 korrik, Paneli i Gjykatës së Apelit në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar k. Pjetër Shalës*, i përbërë nga gjykatëse Mishelë Pikar, gjykatës Kai Ambos dhe gjykatëse Nina Jorgensen, lëshoi aktgjykimin.

Paneli i Apelit la në fuqi verdiktin e fajësisë së z. Shala për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme.

Megjithatë, Paneli i Apelit miratoi, pjesërisht, tri prej 14 pikave që z. Shala paraqiti në apel, hodhi poshtë pikat e tjera të apelit të z. Shala, dhe uli dënimin e tij nga 18 në 13 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.

Në fund, Paneli i Apelit theksoi se ulja e dënimit të z. Shala nuk sugjeron aspak se krimet për të cilat është shpallur fajtor dhe dënuar, nuk janë të rënda.

Paneli i Apelit theksoi gjithashtu se Dhomat e Specializuara kanë juridiksion vetëm mbi individë, e jo grupe apo organizata, dhe se “as UÇK-ja, as populli i Kosovës nuk ishin objekt i këtij procesi dhe nuk u shpallën përgjegjës dhe fajtorë për këto krime”.

Versioni i redaktuar publik i plotë i Aktgjykimit të Apelit gjendet në faqen e internetit të DHSK-së.

Procesi i apelit është pjesë përbërëse e garancisë për gjykim të drejtë. Procesi është krijuar që, pasi një gjykatës ose trup gjykues të ketë lëshuar një vendim ose aktgjykim, personi i akuzuar ose i shpallur fajtor të mund të kundërshtojë atë vendim para një trupi të pavarur gjykatësish që do të rishikojë vendimin.

Gjatë kësaj jave vazhdojnë seancat në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit.

Dje, në sallë të gjyqit, Trupi Gjykues lëshoi vendimin në lidhje me mocionin e përbashkët të Mbrojtjes sipas rregullës 130. Kjo rregull thotë se Trupi Gjykues mund të rrëzojë një akuzë – për shembull një akuzë se dikush ka kryer trajtim çnjerëzor – edhe para se Mbrojtja të paraqesë provat e veta – në qoftë se nuk ekzistojnë prova në mbështetje të një vendimi fajësie jashtë dyshimit të arsyeshëm në lidhje me akuzat në fjalë.

Në kërkesën me shkrim, Mbrojtja kishte kërkuar rrëzimin vetëm të akuzave lidhur me incidentet para fundit të majit 1998 dhe pas 20 qershorit 1999.





Me shpalljen e vendimit të Trupit Gjykses, kryegjykatësi shpjegoi se Mbrojtja kërkonte rrëzimin e fakteve materiale konkrete, ndërsa rregulla 130 lidhet vetëm me mundësinë e rrëzimit tërësisht të një akuze ose akuzave në aktakuzë.

Gjykatësi shpjegoi më tej se aspekti i paraqitur nga Mbrojtja nëse Prokuroria ka vërtetuar mjaftueshëm kuadrin kohor të akuzave, do të shqyrtohet nga Trupi Gjykses në aktgjykimin në fund të kësaj çështjeje gjyqësore.

Pas lëshimit të urdhrit gojor prej Kryegjykatësit, Mbrojtja e Viktimave thirri dy dëshmitare eksperte, Karin Duhne-Prinsen dhe dr. Katherinë Nikola Blek, të cilat po japin dëshmi në lidhje me dëmin psikiatrik/psikologjik të pësuar nga viktimat në këtë çështje gjyqësore. Ato përfunduan dhënien e dëshmisë sot pasi u morën në pyetje nga Prokuroria, ekipet e Mbrojtjes dhe pas pyetjeve të Trupit Gjykses. Këtë javë nuk ka seanca të tjera të planifikuara.

Më 16 korrik, ekipet e Mbrojtjes së Hashim Thaçit dhe Jakup Krasniqit njoftuan Trupin Gjykses se planifikojnë të paraqesin prova të Mbrojtjes, kurse ekipet e Mbrojtjes së Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit njoftuan se nuk planifikojnë të paraqesin prova. Seanca për ecurinë e çështjes gjyqësore është caktuar për të martën e ardhshme, më 22 korrik.

Më 14 korrik, Kryetarja e DHSK-së hodhi poshtë një kërkesë të Haxhi Shalës për lirim të përkohshëm. Kujtojmë se, z. Shala pranoi fajësinë për frikësim gjatë procedurës penale dhe pengim të personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare dhe u dënua me 3 vjet burgim, në të cilin llogaritet koha e kaluar tashmë në paraburgim. Në kërkesën e tij të fundit, z. Shala argumentoi se pasi ka vuajtur gjysmën e dënimit deri më 11 qershor 2025, ai plotëson kriterin për shqyrtim për lirim të përkohshëm sipas Kodit Penal të Kosovës.

Në vendimin e saj, Kryetarja e DHSK-së theksoi se neni 3(4) i DHSK-së thotë shprehimisht se çdo ligj, rregullore, rregullore dytësore, rregull ose zakon tjetër dhe praktikë e Kosovës, që nuk janë përfshirë shprehimisht në këtë ligj, nuk zbatohen për organizimin, administrimin, funksionet apo juridiksionin e Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Vuajtja e dënimeve, ku përfshihet mundësia e lirit të parakohshëm, është pjesë përbërëse e administrimit dhe funksionimit të Dhomave të Specializuara. Rrjedhimisht, është ligji i DHSK-së ai që zbatohet në këtë rast. Sipas këtij ligji personat e dënuar nga Dhomat e Specializuara plotësojnë kriterin për ulje, modifikim ose ndryshim të dënimit vetëm pasi të kenë vuajtur dy të tretat e dënimit të tyre.

Më 16 korrik 2025, Gjykatësi i Vetëm i caktuar për mbikëqyrjen e zbatimit të urdhrit kundër Salih Mustafës për zhdëmtim të viktimave lëshoi një vendim në të cilin konstatoi se Salih Mustafa nuk ka përmbushur detyrimet e tij sipas Urdhrit për Zhdëmtim dhe në të cilin informoi z. Mustafa se do fillojë të llogaritet një





normë interesi prej 8 për qind në vit në lidhje me Urdhrin për Zhdëmtim, i cili ende nuk është zbatuar që prej datës kur ai u njoftua për këtë vendim.

Vendimi lidhet pjesërisht me refuzimin prej z. Mustafa për të plotësuar formularin e deklaramit të mjeteve financiare që do t'i mundësonte gjykatës të përcaktojë se deri në cilën shumë ai mund të paguajë zhdëmtimin, dhe faktin që Administratorja nuk ka marrë ende përgjigje nga z. Mustafa në lidhje me aspektin e pagesave vullnetare për viktimat.

Vendimi i fundit përfshin gjithashtu disa hollësi në lidhje me zbatimin e mëhershëm të urdhrit për zhdëmtim që nuk ishin publike më parë. Në një vendim në mars, Gjykatësi i Vetëm urdhëroi Administratoren të njoftonte z. Mustafa për modalitetet e çdo pagese vullnetare që ai dëshiron të paguajë për të përmbushur detyrimin ndaj viktimave dhe të bënte vlerësimin e mjeteve financiare të z. Mustafa për të përcaktuar nëse mjetet financiare aktuale dhe të ardhshme, duke marrë parasysh nevojat familjare, i mundësojnë atij të paguajë plotësisht zhdëmtimin e urdhëruar, brenda një periudhe të arsyeshme.

Po në atë vendim të marsit 2024, Gjykatësi i Vetëm urdhëroi gjithashtu pagesën e zhdëmtimit për viktimat nga pasuritë e z. Mustafa, që rrjedhimisht zbaton Urdhrin e Zhdëmtimit. Më 19 korrik 2024, Administratorja informoi Gjykatësin e Vetëm se urdhri i tij në lidhje me pagesën e (pjeshme) të zhdëmtimit për viktimat ishte zbatuar dhe ajo parashtroi një tabelë me hollësi për shumën proporcionale që i është paguar secilës viktimë.

